

2012/02

# Opsionet për Reformën Zgjedhore në Kosovë



INDEP përkrahet nga Fondi i Vëllëzërve Rockefeller (RBF). Pjesë të këtij punimi janë përkrahur nga Fondacioni Friedrich Ebert (FES).

Autor: **Dita Dobranja dhe Burim Ejupi**

Redaktor: **Krenar Gashi**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

324(496.51) 1. Dobranja, Dita 2. Ejupi, Burim

Opsionet për Reformën Zgjedhore në Kosovë /

Dita Dobranja dhe Burim Ejupi.

Prishtinë : Instituti për Politika Zhvillimore, 2012. - 17 f. ; 30 cm.

ISBN 978-9951-627-02-3



**Bashkëpunimi Rajonal**  
Regional Cooperation



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development



**Qeverisja Demokratike**  
Democratic Governance

## PËRMBAJTJA

1. REFORMA ZGJEDHORE .....	2
2. NDARJA E KOSOVËS NË ZONA ZGJEDHORE .....	5
I. 100 Zona Zgjedhore (100+10+10) .....	5
II. 37 Zona (100+10+10).....	6
III. Më shumë se 20 Zona në sistem të përzier (70 +30+10+10) .....	7
IV. Shtatë Zona Zgjedhore .....	8
a) Sistemi mazhoritar (100+10+10) .....	9
b) Sistemi i përzier (70+30+10+10) .....	10
c) Përparësitë dhe mangësitë e ndarjes së Kosovës në 7 zona.....	11
V. Gjashtë Zona Zgjedhore.....	11
a) Sistemi mazhoritar (100+10+10) .....	12
b) Sistemi i përzier (70+30+10+10) .....	12
c) Përparësitë dhe mangësitë e ndarjes së Kosovës në gjashtë zona .....	13
VI. Një Zonë Zgjedhore .....	13
3. REKOMANDIME.....	16

## 1. REFORMA ZGJEDHORE

Në seancën plenare të 22 prillit 2011, me 76 vota për, 6 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi i Kosovës formoi Komisionin Ad-Hoc për Amandamentim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, koha e veprimit të të cilit duhej të ishte 8-12 muaj<sup>1</sup>. Detyra e Komisionit ishte ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të cilat do të krijonin parakushte për një sistem zgjedhor që do të sigurote votim dhe zgjedhje demokratike. Puna e Komisionit për Amandamentim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe e Grupit Punues për Reformë Zgjedhore filloi në vitin 2011 dhe është duke vazhduar edhe më tej.

Anëtarë të Grupit Punues ishin jo vetëm përfaqësuesit e partive politike që përfaqësohen në Komisionin për Amandamentim të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, por edhe organe që drejtpërdrejt janë të përfshirë në zgjedhje si Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), pjesëtarë të shoqërisë civile me eksperiencë në zgjedhje si dhe organizata ndërkombëtare të specializuara në këtë çështje. Puna e Grupit Punues për Zgjedhje u monitorua nga shërbyes civil të Kuvendit të Kosovës, organizata të tjera jo-qeveritare lokale dhe ndërkombëtare si dhe etnitete të tjera me interes në procesin e reformës zgjedhore. Kjo përbërje ka mundësuar që diskutimet në Grupin Punues të mos reflektojnë vetëm bindjet e partive politike por edhe ato të hisedarëve tjerë të përfshirë në sistemin zgjedhor.

Grupi Punues për zgjedhje me një përbërje kaq të gjerë ka diskutuar të gjitha dispozitat ligjore dhe pikat të cilat kanë qenë të hapura për ndryshim e që janë brenda mandatit të Komisionit për Amandamentim të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme. Para diskutimit dhe aprovimit në Komision, në Grup Punues janë marrë parasysh rekomandimet e të gjithë anëtarëve dhe këshillat e organizatave ndërkombëtare në duke filluar nga çështjet teknike e deri te ato mbi sistemin zgjedhor që kanë të bëjnë me listat e kandidatëve dhe zonat zgjedhore. Rekomandimet e dala nga Grupi Punues janë votuar tutje nga Komisioni si trup politik.

Gjatë punës së Grupit Punues për Reformë Zgjedhore është arritur një konsensus i plotë në mes të anëtarëve sa i përket çështjeve teknike të cilat shkaktuan probleme në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës, duke filluar nga listat e votuesve, financimi dhe fushata e partive politike e deri te vëzhguesit e zgjedhjeve dhe Komisioni Qendror Zgjedhor. Këto ndryshime do ta përmirësojnë ambientin në ditën e zgjedhjeve dhe gabimet teknike mund të mënjanohen.

Reforma zgjedhore nuk synon të sigurojë demokratizimin e partive ose të ndryshojë sistemin politik duke dobësuar një parti e forcuar një tjetër, e as që t'i jep fund keqpërdorimeve zgjedhore. Kjo reformë synon **të sigurojë një sistem zgjedhor demokratik në të cilin qytetarët e Kosovës zgjedhin përfaqësuesit e vet si deputetë në Kuvendin e Kosovës dhe të sigurojë një sistem i cili do t'i japë fund parregullsive dhe gabimeve teknike që ndodhën si rezultat i paqartësive në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.** Reforma zgjedhore gjithashtu ka për qëllim të lehtësojë sistemin e votimit për qytetarët në mënyrë që të zvogëlohet numri i votave të pavlefshme dhe kështu të rritë legjitimitetin e zgjedhjeve.

---

<sup>1</sup> Procesverbali i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 22 Prill 2011

Numri i votave të pavlefshme ka rënie të konsiderueshme nga një palë zgjedhje në tjerat, mirëpo aplikimi i një sistemi më të thjeshtë të votimit tenton të eliminojë numrin e votave të pavlefshme tërësisht, në mënyrë që asnjë votë të mos humbet dhe kështu të rritet besimi i qytetarëve në sistemin zgjedhor. Sistemi zgjedhor nuk është përgjegjës për rregullimin dhe demokracinë e brendshme të subjekteve politike dhe prandaj ky nuk mund të sigurojë se diçka e tillë do të arrihet. Në anën tjetër, as ndryshimi i sistemit zgjedhor nuk i ndalon parregullsitë zgjedhore të hasura në zgjedhjet e vitit 2010 apo të ato paraprake në Kosovë. Parandalimi i keqpërdorimeve gjatë zgjedhjeve mund të arrihet vetëm me anë të zbatimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Kodit Penal të Kosovës. Aktualisht janë rreth 1.300 persona duke u gjykuar për keqpërdorimet në zgjedhjet e vitit 2010. Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që mund të rezultojnë në ndryshimin e sistemit zgjedhor ka për qëllim t'i mënjanojë parregullsitë dhe gabimet teknike, çështje për të cilat Grupit Punues për Reformën Zgjedhore ka votuar tashmë.

Bazuar në Kushtetutën e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka njëqind e njëzet (120) deputetët që zgjidhen nga qytetarët me vota të fshehta dhe lista të hapura<sup>2</sup>. Nga këta 120 deputetë, deri në zgjedhjet e vitit 2010, 20 ulëse ishin të rezervuara për partitë minoritare (10 për komunitetin serb e 10 për komunitetet tjera), ndërsa duke filluar nga zgjedhjet e ardhshme, 20 ulëset e partive minoritare do të jenë të garantuara.<sup>3</sup> “Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.”<sup>4</sup> Sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kosova mban zgjedhje çdo 4 vite, në të cilat, qytetarët votojnë për 5 kandidatë në një zonë zgjedhore dhe pragu zgjedhor për parti është 5%, duke mos përfshirë partitë minoritare për të cilat pragu është 1%<sup>5</sup>. Në zgjedhjet e ardhshme nuk do të ketë prag për partitë minoritare, pasi që vendet për këto parti do të jenë të garantuara, dhe nëse një subjekt politik që përfaqëson minoritetet tejkalon vendet e garantuara, atëherë, fiton ulëse më shumë. Duke u bazuar në numrin e votuesve dhe në numrin e votave që i kanë fituar partitë që përfaqësojnë komunitetet në Kosovë, nuk ka gjasa që të fitojnë më shumë vende se sa që i kanë të garantuara me Kushtetutë. Si shembull, votues të komunitetit Serb në Kosovë në zgjedhjet e 2010 ishin rreth 70,000 e numri total i qytetarëve që kanë votuar në zgjedhjet e 2010 ishte 706,317, që do të thotë që edhe nëse dalja në votime nga komuniteti Serb të jetë 100%, prapë se prapë subjektet politike Serbe nuk do të mund të fitojnë më shumë se 10 vendet tanimë të garantuara. Megjithatë, kjo nuk duhet paragjykuar për të ardhmen.

Gjatë debatit rreth Reformës Zgjedhore kishte konsensus për ruajtjen e kuotës gjinore prej 30% dhe mos ndryshimin e numrit të deputetëve prej 120 sosh. Çështjet të cilat mbetën të hapura, janë mënyra e zgjedhjes së 100 deputetëve në mënyrë të drejtpërdrejt. Këtu përfshihen vendimet mbi listat e kandidatëve, formën e votimit, zonat zgjedhore dhe nëse ndarja e ulëseve në këto zona duhet të jetë në formë mazhoritare apo miks. Deri më tani, në këto çështje jo vetëm që nuk pati konsensus në mes të anëtarëve të Grupit Punues për Reformë Zgjedhore, por ndarja (apo mos ndarja) e Kosovës në zona zgjedhore dhe hapja (apo mbyllja) e listave të kandidatëve ende

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 64 [Struktura e Kuvendit]

<sup>3</sup> Propozimin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës i Presidentit Martti Ahtisaari; Aneksi 1 mbi Provizionet Kushtetuese, Neni 3 mbi Kuvendin e Kosovës

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 64 [Struktura e Kuvendit]

<sup>5</sup> Ligji Nr. 03/L-073, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë

vazhdojnë të debatohen. Këto çështje janë në të njëjtën kohë edhe më të rëndësishmet për të krijuar bazën e ndryshimit të tërësishëm të sistemit zgjedhor. Mungesa e vendimmarrjes në disa parti politike rreth zonave zgjedhore dhe listave është e bazuar më shumë në interesat e tyre politike se sa në parimin e përmirësimit të sistemit zgjedhor në Kosovë, kjo si rezultat i asaj se këto dy ndryshime janë qenësore në kalkulimet politike.

Çështjet të cilat janë debatuar edhe në Komision por edhe në Grupin punues, e për të cilat nuk ka konsensus janë:

- Sistemi (proporcional apo mazhoritar);
- Zonat (a duhet Kosova të ndahet në zona zgjedhore, apo të mbetet një zonë zgjedhore si deri më tani);
- Listat (të hapura apo të mbyllura).

Nëse listat mbeten të hapura duhet të debatohet edhe çështja e votave:

- Vota (mundësia që qytetari të votojë vetëm për një apo për më shumë kandidatë siç është edhe tani në ligj).

Paralelisht me formimin e Komisionit për Amandamentim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Kuvendi i Kosovës formoi Komisionin për Amandamentim të Kushtetutës i cili është përgjegjës për amandamentimin e provizioneve kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës në Kapitullit V. Në mandatin e Komisionit për Amandamentim të Kushtetutës parashihet që në rast të nevojës së ndryshimeve të dispozitave të sistemit zgjedhor mbi zonat zgjedhore dhe listat e kandidatëve të kërkuara nga Komisioni për Amandamentim të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, këto duhet të bëhen para përfundimit të mandatit të Komisionit për Amandamentim të Kushtetutës. Rekomandimet e Komisionit për Amandamentim të Kushtetutës tashmë janë dërguar dhe në to nuk figurojnë ndryshimet në numrin e zonave zgjedhore apo të listave të kandidatëve. Duke pasur parasysh që Komisioni për Amandamentim të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme nuk ka dërguar rekomandime për këto dy provizione, pasi që vendimet ende nuk janë marrë nga partitë politike, dhe mandati i Komisionit për Amandamentim të Kushtetutës është përmbyllur, ndryshimet në numër të zonave zgjedhore dhe në lista të kandidatëve bëhen ligjërisht të pamundshme.

## 2. NDARJA E KOSOVËS NË ZONA ZGJEDHORE

Debati për ndarjen e Kosovës në shumë zona është bazuar kryesisht në argumentin e përfaqësimit dhe llogaridhënies duke aluduar se shumë zona zgjedhore do të siguronin përfaqësim dhe llogaridhënie më të drejt. Derisa në parim këto pohime duken të sakta, gjatë punës hulumtuese vërehen mangësi në ndarjen e Kosovës në zona zgjedhore, mangësi të cilat paraqesin regres për demokracinë e sistemit zgjedhor në Kosovë. Që votimi në zona të realizohet, kërkon që fillimisht të bëhet ndarja e listave të votuesve bazuar në zonat elektorale, që do të përfshinte edhe ndarjen e listave të minoriteteve. Për tu bërë ky sistematizim i listave do të kërkonte që votuesit të deklarorin përkatësinë e tyre etnike paraprakisht, gjë kjo që është në kundërshtim të drejtpërdrejt me parimet e përgjithshme ndërkombëtare si dhe me direktivat mbi minoritete të Komisionerit të Lartë për Minoritete Kombëtare të OSCE.<sup>6</sup>

Në vazhdim do të paraqiten anët pozitive dhe negative të ndarjes së Kosovës në zona zgjedhore, duke filluar nga opsioni me 100 deri tek ai me 6 zona.

### I. 100 Zona Zgjedhore (100+10+10)

Një nga propozimet e subjekteve; politike në Kosovë është që Kosova të ndahet në 100 zona zgjedhore, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë do të zgjidheshin 100 deputetë për Kuvendin e Kosovës. Me këtë propozim në Kosovë do të kemi një sistem mazhoritar ku secila zonë do ta zgjedhë deputetin e vet, kurse minoritetet do të përfaqësohen me vendet e garantuara.

Një sistem i tillë, pikën më të fortë e ka forcimin e llogaridhënies dhe përfaqësimit të drejtpërdrejtë, mirëpo, kjo mënyrë e zgjedhjes së deputetëve shfaq probleme të shumta. Përparësitë dhe mangësitë e një sistemi të tillë mazhoritar janë si vijojnë:

#### **Përparësitë:**

- Qytetarët do të dinë se cili do të jetë deputeti i tyre dhe do të kenë mundësi që brenda zonës së tyre elektorale të zgjedhin kandidatin më të mirë;
- Kandidatët e pavarur do të kenë mundësi më të mëdha për tu zgjedhur;
- Lidhja në mes të qytetarit (votuesit) dhe deputetit forcohet duke u siguruar përfaqësimi dhe llogaridhënia e drejtpërdrejtë.

#### **Mangësitë:**

- Pesha e votës së votuesve dallon nga zona në zonë, që e bën këtë sistem më pak demokratik;
- Rritet mundësia që një subjekt politik në nivel vendi të mund t'i fitojë mbi 30% të votave, nuk do të përfaqësohet në Kuvend. Duke u bazuar në argumentin e mësipërm, mund të konkludojmë që përbërja e Kuvendit të Kosovës nuk do të pasqyrojë forcat e vërteta politike në nivel vendi. Kështu, një sistem zgjedhor në të cilin Kosova ndahet në 100 zona, nuk do të garantoj përfaqësim në nivel kombëtar por vetëm në atë zonal;

---

<sup>6</sup> Intervistë e INDEP me zyrën e Komisionerit të Lartë për Minoritete Kombëtare të OSBE, Bruksel, 2011

- Edhe pse Komisioni për Amandamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ka arritur konsensus që kuota gjinore prej 30% të mos ndryshohet, një sistem në të cilin secila zonë e zgjedhë një deputet nuk e garanton përmbushjen e kësaj kuote;
- Duke pasur parasysh që në një zonë zgjidhet një deputet, votuesit që i përkasin pakicave kombëtare nuk do të votojnë në zonat ku nuk janë shumicë, duke qenë të vetëdijshëm që kandidati i tyre nuk mund të fitojë. Kjo do të shkaktojë probleme në ndarjen e ulëseve të garantuara për minoritetet;
- Duke u bazuar në argumentin e mësipërm, e njëjta vlen edhe për votuesit shqiptarë në zonat ku janë pakicë. Këta votues nuk do të votojnë kandidatët e tyre për faktin që mundësia që ata të zgjidhen është minimale. Një sistem i tillë po shërben si nxitës për mos dalje në zgjedhje të një numri të konsiderueshëm të votuesve;
- Nuk ka prag zgjedhor;
- Do të shkaktohen probleme gjatë ndarjes së zonave. Secila zonë do të ketë numër të njëjtë ose së paku të përafërt të votuesve në mënyrë që të garantohet pesha e njëjtë e votës për të gjithë votuesit. Në këtë mënyrë do të duhej që disa lokalitete dhe komuna të vogla të bashkohen në mes veti për të dhënë numrin e duhur të votuesve. Kjo do të rezultojë në ndryshime të zonave para të gjitha zgjedhjeve të përgjithshme nga momenti kur fillon të implementohet një sistem i tillë (numri i votuesve për një komunitet ndryshon si rezultat i natalitetit/mortalitetit, i migrimit të popullsisë, etj);
- Bazuar në argumentin e mësipërm, duhet të ceket se ndarja e Kosovës në 100 zona zgjedhore lë vend për manipulime politike rreth formimit të zonave zgjedhore. Partitë politike do të përdorin rezultatet e zgjedhjeve paraprake ose të forcës së tyre politike në rajone të caktuara për të formuar zonat zgjedhore në mënyrë që të minimizojnë efektin e votave kundër subjektit të tyre dhe të rrisin rëndësinë e votave në favor të tyre;
- Në disa zona do të mund të kishte raund të dytë të zgjedhjeve – si në zgjedhje komunale – dhe kjo rezulton në kosto më të madhe të mbajtjes së zgjedhjeve.

## II. 37 Zona (100+10+10)

Një propozim tjetër për ndarjen e Kosovës ka qenë ndarja në 37 zona zgjedhore bazuar në numrin aktual të komunave. Një propozim i tillë ka lënë të hapur debatin se a do të zgjidhen 100 deputetë drejtpërdrejt nga 37 zonat, apo sistemi do të jetë një kombinim që 70 deputetë të zgjidhen në zona, ndërsa 30 të fitojnë mandat në nivel vendi, në mënyrë që të garantohet përfaqësimi më i drejtë në nivel vendi dhe ruajtja e kuotës gjinore. Ky sistem deri në një masë siguron përfaqësimin dhe llogaridhënien, dhe në rast se bëhet ndarja e mandateve nga zonat si dhe në nivel vendi, atëherë ky sistem tentativisht garanton edhe kuotën gjinore dhe nuk diskriminon partitë në baza rajonale.

### Përparësitë:

- Qytetarët do të dinë se cili është deputeti i tyre duke e votuar kandidatin më të mirë në zonën e tyre zgjedhore;
- Mundësia e zgjedhjes për kandidatët e pavarur rritet;



- Llogaridhënia dhe përfaqësimi i drejtpërdrejt sigurohet nga votimi në zona;
- Me mundësinë që 30 deputetë të zgjidhen duke u bazuar në votat në nivel vendi, sigurohet ruajtja e kuotës gjinore.

#### **Mangësitë:**

- Ndarja e Kosovës në zona duke u bazuar në komuna rezulton që pesha e votës së votuesve në komuna të mëdha do të jetë më e vogël se pesha e votës së votuesve në komuna me më pak votues;
- Ndarja e Kosovës në zona bazuar në ndarjen në komuna rezulton në përzgjedhjen e liderëve lokal si deputetë të Kuvendit të Kosovës. Në këtë mënyrë ulet rëndësia e zgjedhjeve si për asamblenë komunale, ashtu edhe për Kryetar të Komunës;
- Subjektet politike mund të fitojnë numër të konsiderueshëm të votave në nivel kombëtar, mirëpo me një sistem të tillë atyre nuk do t'i sigurohet përfaqësimi në Kuvend. Kjo ndodh sepse në disa komuna ka sistem mazhoritar, ku duke u bazuar në numrin e votuesve do të zgjidhet vetëm një deputet;
- Përveç sistemit mazhoritar që do të ekzistojnë në disa komuna, një ndarje e tillë bazuar në ndarjen administrative të komunave e jo në numrin e votuesve na lë të kuptojmë që disa komuna edhe pse me numër më të vogël të votuesve se numri i nevojshëm për të fituar një mandat, do të ketë zgjedhje të një deputeti;
- Forca e vërtetë politike në nivel vendi nuk do të përfaqësohet në Kuvend, duke u bazuar në argumentet e mësipërme (edhe pse në rast se ky sistem do të bazohet në ndarjen e mandateve në nivel zone (komunal) dhe nivel vendi, një gjë e tillë nuk do të ndodhë).

### **III. Më shumë se 20 Zona në sistem të përzier (70 +30+10+10)**

Disa organizata të shoqërisë civile propozojnë që Kosova të ndahet në më shumë se 20 zona ku në mënyrë direkte do të zgjedhen 70 deputetë, kurse 30 deputetë do të zgjedhen në bazë të proporcionalitetit, ku në radhët e këtyre 30 deputetëve do të ruhet kuota gjinore, si dhe nuk do të humbin votat e qytetarëve që kanë votuar në një zonë, ku deputeti është zgjedhur nga një subjekt tjetër.

#### **Përparësitë:**

- Qytetarët, edhe me këtë sistem, do të kenë afërsi më të madhe me deputetët e zgjedhur dhe mund të argumentohet se llogaridhënia dhe përfaqësimi do të rritet;
- Kandidatët e pavarur do të kenë gjasa më të mëdha për të fituar mandatin, duke pasur parasysh që do të kandidojnë në një nga zonat ku mund të garojnë për një deri në tri mandate;
- Me mundësinë që 30 deputetë të zgjedhen duke u bazuar në votat në nivel vendi, sigurohet ruajtja e kuotës gjinore dhe mbajtja e balancës së mandateve të fituar nga forcat politike në nivel vendi.

### **Mangësitë:**

- Si në të gjitha rastet me ndarjen në zona, edhe ndarja e Kosovës në më shumë se 20 zona rezulton në mungesë të baraspeshës së votave të votuesve prej zonës në zonë;
- Si edhe për ndarjen në komuna, ndarja e Kosovës në 20 e më tepër zona rezulton në fuqizimin e rëndësisë së liderëve lokal në zgjedhjet e përgjithshme, gjë që e ulë rëndësinë e këtyre liderëve në zgjedhjet lokale, si ato për Asamble Komunale ashtu edhe për Kryetar të Komunave;
- Gara për mandat nuk do të jetë e barabartë në të gjitha zonat. Në zona ku do të kemi sistem mazhoritar (1 mandat për zonë) gara do të jetë më e vështirë se në zonat që japin 3 mandate;
- Edhe me këtë sistem, dekurajohet votimi i pakicave kombëtare në zona. Në ato zona ku zgjidhet vetëm një deputet nuk do të ketë dalje në zgjedhje të pakicave kombëtare në atë zonë (qofshin ato shqiptare apo jo-shqiptare). Në rastin kur kjo është e vërtetë për pakicat kombëtare jo-shqiptare, dëmi tjetër që do të shkaktohet është vështirësia e ndarjes së mandateve të garantuara për këto minoritete si rezultat i mungesës së votimit nga ana e tyre.

### **IV. Shtatë Zona Zgjedhore**

Një propozim i kamotshëm në Kosovë është ndarja në shtatë Zona Zgjedhore, të cilat do të ishin: Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova, Mitrovica, Ferizaj, dhe Gjilani. Komunat që do të përfshihen në secilën nga gjashtë zonat paraqiten në tabelën në vijim.

<b>Prishtinë</b>	<b>Ferizaj</b>	<b>Mitrovicë</b>	<b>Prizren</b>	<b>Gjilan</b>	<b>Pejë</b>	<b>Gjakovë</b>
Glogovc	Kaçanik	Mitrovicë	Dragash	Gjilan	Pejë	Gjakovë
Fushë Kosovë	Shtime	Leposaviç	Prizren	Kamenicë	Istog	Deçan
Lipjan	Štrpce	Skenderaj	Suharekë	Novobërdë	Klinë	Junik
Obiliq	Ferizaj	Zubin Potok	Mamushe	Viti		
Podujevë	Hani i Elezit	Zveçan	Malishevë	Ranillug		
Prishtinë		Vushtri	Rahovec	Partesh		
Graçanicë				Killokot		

### a) Sistemi mazhoritar (100+10+10)

Në vijim shihet sa deputetë do të jepte secila zonë, nëse 100 deputetë të Kuvendit të Kosovës do të përzgjedheshin nga 7 zona:

Shtatë zona - 100 deputetë				
Zona	Numri i votuesve për zonë ( a )	Numri i deputetëve për zonë ( c ) [(a/b)*100]	Numri i votuesve për deputetë ( d ) [a/c]	Numri total i votuesve në Kosovë ( b )
Prishtina	400,146	24	16,672	1,630,636
Ferizaj	165,044	10	16,504	
Mitrovicë	232,222	14	16,587	
Prizren	286,055	18	15,891	
Gjilan	184,994	11	16,817	
Peja	173,204	11	15,745	
Gjakova	188,971	12	15,747	

Në rast të shtatë zonave nga të cilat dalin 100 deputetë, dallimi në mes të deputetëve nga zona e Prishtinës dhe ajo e Ferizajt është afërsisht e njëjtë, mirëpo numri i deputetëve nga zonat tjera përafrohet më tepër. Sidoqoftë, dallimi në mes të votave të nevojshme për të fituar mandat në mes të Gjilanit dhe Prizrenit, Pejës e Gjakovës rritet më shumë, në mbi 6% të numrit total të votave të nevojshme për mandat. Ky dallim rritet tejet më shumë në mes të zonave kur kemi parasysh se rreth 5% e votuesve në zonën e Prizrenit, dhe mbi 15% votues në zonën e Mitrovicës u përkasin komuniteteve dhe supozohet që ata do të votojnë për deputetët që do t'i marrin 20 vendet e garantuara për ta në parlament. Kështu 1 deputet në zonën e Prizrenit dhe 2 në zonën e Mitrovicës do t'i kalojnë drejtpërdrejt partive më të mëdha në këto dy zona. Në këtë mënyrë kandidatët e këtyre partive në këto zona do të fitojnë statusin e deputetit me shumë më pak vota se deputetët në zonat tjera.

Përveç mungesës së barazisë në peshë të votuesit nga një zonë në tjetrën, një ndarje e tillë rritë rrezikun që një parti edhe pse ka fituar numër të mjaftueshëm të votave për të fituar mandate në nivel nacional, për faktin që këtë nuk e ka arritur në secilën zonë, partia mbetet jashtë parlamentit. Kjo e bënë këtë sistem jo të barabartë për partitë në garë.

Ndarja e Kosovës në zona zgjedhore dhe votimi për 100 deputetë në zona do të rrezikonte ruajtjen e kuotës gjinore, edhe pse ajo si e tillë nuk është prekur nga Komisioni për Amandamentimin e Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme. Në rast se në 3 e më tepër zona zgjedhore nga një kandidat i gjinisë mashkullore i një partie fiton mandat, atëherë kuota gjinore nuk do të ruhet, duke pasur parasysh se ajo parti do të ketë 4 deputetë meshkuj, duke mos e përmbushur kuotën gjinore prej 30%.

## b) Sistemi i përzier (70+30+10+10)

Që të ruhet proporcionaliteti dhe që mos të humben votat e subjekteve që nuk e mbërrijnë pragun natyral në zona, propozohet opsioni që 70 deputetë të zgjedhen nëpër zona e 30 në mënyrë proporcionale. Në vijim shihet sa deputetë do të jepte secila zonë nëse 70 deputetë të Kuvendit të Kosovës do të përzgjedheshin nga 7 zona, ndërsa 30 të tjerë në nivel vendi.

Shtatë zona - 70 deputetë				
Zona	Numri i votuesve për zonë ( a )	Numri i deputetëve për zonë ( c ) [(a/b) * 70]	Numri i votuesve për deputetë ( d ) [a/c]	Numri total i votuesve në Kosovë ( b )
Prishtina	400,146	17	23,538	1,630,636
Ferizaj	165,044	7	23,578	
Mitrovicë	232,222	10	23,222	
Prizren	286,055	12	23,838	
Gjilan	184,994	8	23,124	
Peja	173,204	8	21,651	
Gjakova	188,971	8	23,621	

Ndarja e Kosovës në shtatë zona nga të cilat do të fitonin mandate 70 deputetë edhe pse e përafrojmë me tutje numrin e deputetëve që vijnë nga secila zonë, ajo e rritë edhe më tepër numrin e votave të nevojshme për të fituar mandat në Kuvendin e Kosovës. Dallimi në mes të Prizrenit dhe Pejës është 2,187 vota që është rreth 10% e votave totale të nevojshme për t'u bërë deputetë nga një zonë. Dallimi në numër të votave rritet ende kur e marrim parasysh numrin e pakicave kombëtare në zonat si Prizreni dhe Mitrovica, për dallim prej zonave si Peja dhe Gjakova. Pesa e votës së votuesit mbetet tutje e ndryshme nga një zonë në tjetrën, dhe kjo është e papranueshme në një sistem demokratik.

Derisa një sistem ku 30 deputetë në Kuvendin e Kosovës fitojnë mandate nga votat e fituara në nivel nacional mundohet të rregullojë ruajtjen e kuotës gjinore dhe barazinë në garë zgjedhore, në praktikë do të shërbej për të mbajtur një strukturë të Kuvendit të ngjashme me atë që kemi momentalisht, kur votohet në një zonë zgjedhore. Kjo do të jetë si rezultat i po atyre 30 deputetëve që do të fitojnë mandate në nivel nacional, të cilët bazuar në listat e deritashme të kandidatëve të partive politike do të jenë në shumicë të regjistruar dhe rezident në Komunën e Prishtinës dhe kjo do të rezultonte në afërsisht 50 deputetë nga Komuna e Prishtinës, që është afërsisht njëjtë me strukturën e tanishme, ku 56 deputetë janë të regjionit të Prishtinës, e 41 të Komunës së Prishtinës.

### c) Përparësitë dhe mangësitë e ndarjes së Kosovës në shtatë zona

#### Përparësitë:

- Mund të argumentohet që një sistem i tillë gjithashtu luan rolin e afrimit të qytetarit/votuesit me deputetët, por jo në atë masë si ndarja në më shumë zona;
- Kandidatët e pavarur, edhe me këtë sistem do të kenë më shumë mundësi të fitojnë mandat, edhe pse gjasat me ndarjen në 7 zona janë shumë më të vogla;
- Nëse aplikohet sistemi miks në të cilin 30 deputetë zgjedhen me vota në nivel vendi, sigurohet ruajtja e kuotës gjinore dhe mbajtja e balancës së mandateve të fituar nga forcat politike në nivel vendi.

#### Mangësitë:

- Mangësia kryesore e ndarjes në shtatë zona është ndryshimi i peshës së votuesve nga një zonë në tjetrën. Në zonat ku ka pakica minoritare si ajo e Prizrenit dhe Mitrovicës, mandatet fitohen me më pak vota se në zonën e Pejës ku numri i pakicave është më i vogël;
- Përveç kësaj, një sistem i tillë mund gjithashtu të dekurajojë votuesit e pakicave në zona, duke pasur parasysh faktin që votat e tyre shkojnë drejt vendeve të garantuara;
- Nuk ka prag zgjedhor.

## V. Gjashtë Zona Zgjedhore

Ndarja e Kosovës në gjashtë apo shtatë zona, ka ndryshim ndarjen e qytetit të Gjakovës si zonë të veçantë në rastin e ndarjes në shtatë zona. Numri i deputetëve që do të dilnin nga secila zonë përveç që varet nga numri i votuesve në atë zonë, varet po ashtu edhe nga sistemi i cili do të aplikohet për ndarjen e ulëseve.

<b>Prishtinë</b>	<b>Ferizaj</b>	<b>Mitrovicë</b>	<b>Prizren</b>	<b>Gjilan</b>	<b>Pejë</b>
Glogovc	Kaçanik	Mitrovicë	Dragash	Gjilan	Gjakovë
Fushë Kosovë	Shtime	Leposaviç	Prizren	Kamenicë	Pejë
Lipjan	Štrpce	Skenderaj	Suharekë	Novobërdë	Istog
Obiliq	Ferizaj	Zubin Potok	Mamushë	Viti	Klinë
Podujevë	Hani i Elezit	Zveçan	Malishevë	Ranillug	Deçan
Prishtinë		Vushtrri	Rahovec	Partesh	Junik
Gracanica				Klllokot	

Ndarja e Kosovës në gjashtë zona duke u nisur në ndarjen që bënë Ministria e Punëve të Brendshme me regjistrimet e makinave. Në bazë të kësaj ndarjeje ka propozime që edhe Kosova të ndahet në 6 zona zgjedhore. Ndarja e Kosovës në 6 zona e parasheh atë të ndarë në zonën e

Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Mitrovicës, Ferizajt dhe Gjilanit. Komunitet që do të përfshihen në secilën nga gjashtë zonat shihen në tabelën e mësipërme.

### a) Sistemi mazhoritar (100+10+10)

Në vijim shihet sa deputetë do të jepte secila zonë nëse 100 deputetë të Kuvendit të Kosovës do të përzgjidheshin nga 6 zona:

Gjashtë zona - 100 deputetë				
Zona	Numri i votuesve për zonë ( a )	Numri i deputetëve për zonë ( c ) [(a/b)*100]	Numri i votuesve për deputetë ( d ) [a/c]	Numri total i votuesve në Kosovë ( b )
Prishtina	400,146	25	16,005	1,630,636
Ferizaj	165,044	10	16,504	
Mitrovica	232,222	14	16,587	
Prizren	335,376	21	15,970	
Gjilan	184,994	11	16,817	
Peja	312,854	19	16,466	

Në rast të aplikimit të sistemit mazhoritar me gjashtë zona zgjedhore, siç shihet më lartë, duke pasur parasysh që numri i votuesve nga një zonë në tjetrën dallon, deputetët do të garonin për 25 ulëse në Prishtinë, ndërsa për 10 në Ferizaj. Dallimi në mes të votave të nevojshme për të fituar mandat nga Gjilani në Prizren është 847 vota, që është mbi 5% e votave totale që një kandidat duhet t'i fitojë për tu bërë deputet.

### b) Sistemi i përzier (70+30+10+10)

Për të përmirësuar problemet e mësipërme të pabarazisë në garë, në rast se një parti fiton vota të mjaftueshme në nivel nacional por jo zonal, dhe të humbjes së kuotës gjinore, disa argumentojnë në favor të një sistemi miks, ku 70 deputetë fitojnë mandate në zona ndërsa 30 në nivel nacional. Në vijim paraqiten tabelat në të cilat përshkruhet ndarja e mandateve në bazë të zonave në rast të një sistemi miks.

Gjashtë zona - 70 deputetë				
Zona	Numri i votuesve për zonë ( a )	Numri i deputetëve për zonë ( c ) [(a/b) * 70]	Numri i votuesve për deputetë ( d ) [a/c]	Numri total i votuesve në Kosovë ( b )
Prishtina	400,146	17	23,538	1,630,636
Ferizaj	165,044	7	23,578	
Mitrovicë	232,222	10	23,222	
Prizren	335,376	14	23,955	
Gjilan	184,994	8	23,124	
Peja	312,854	14	22,347	

Në një sistem të tillë, edhe pse mund të argumentohet se partitë e kanë mundësinë e fitimit të mandateve në nivel nacional dhe se kuota gjinore do të ruhet, mund të shihet se dallimi në numër të nevojshëm të votave për të fituar mandat nga një zonë në tjetrën është më i lartë se në sistemin e mëparshëm. Dallimi në mes të votave të nevojshme në Prizren dhe në Pejë është 1,609 vota, dhe kjo është rreth 7% e totalit të votave. Në anën tjetër me këtë sistem numri i deputetëve nga një zonë në tjetrën përafrohet edhe më tej.

### **c) Përparësitë dhe mangësitë e ndarjes së Kosovës në gjashtë zona**

#### **Përparësitë:**

- Ideja për ndarjen e Kosovës në 6 zona zgjedhore gjithashtu rrjedhë si rezultat i tentimit për të afruar kandidatët me qytetarët, megjithatë, INDEP vë në pikëpyetje këtë përparësi
- Edhe ky sistem i ofron më shumë mundësi kandidatëve të pavarur;
- Me aplikimin e sistemit miks, do të ruhej kuota gjinore dhe baraspesha e forcave politike në nivel të vendit.

#### **Mangësitë:**

- Pesha e votës së votuesve dallon nga zona në zonë edhe nëse Kosova ndahet në 6 zona zgjedhore, gjë që e bën një ndarje të tillë më pak demokratike;
- Sistemi i tillë, si sistemet e ndarjes në zona në përgjithësi, i dekurajojnë votuesit e pakicave për të votuar në zona ku ata e dinë që nuk do të kenë ndikim;
- Nuk ka prag zgjedhor.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) gjatë simulimit të ndarjes së ulëseve të Kuvendit të Kosovës me Zona Zgjedhore, ka vërejtur një mospërputhje në mes të numrit të nevojshëm të votave për të fituar mandat në Kuvendin e Kosovës nga zona në zonë. Në zonat ku ka numër të madh të pakicave kombëtare, siç është Mitrovica, deputetët fitojnë mandat me më pak vota se votat e nevojshme për të fituar mandat si për shembull në zonën e Pejës ku numri i pakicave kombëtare është më i vogël. Ndarja e numrit të deputetëve nga secila zonë varet drejtpërdrejt nga numri i votuesve në ato zona.

## **VI. Një Zonë Zgjedhore**

INDEP ka marrë parasysh të gjitha sugjerimet e deritanishme për ndarjen në zona zgjedhore dhe pas studimit të detajuar ka arritur në përfundim që zgjedhja më e mirë për Kosovën është të mos bëhet ndarja në zona zgjedhore. Kosova duhet të mbetet një zonë zgjedhore, ku votohet me lista të hapura për një kandidat dhe ku pragu zgjedhor është 1%.

#### **Përparësitë:**

- Duke votuar në një zonë dhe për një kandidat, sigurohet përfaqësimi dhe llogaridhënia; Qytetarët votojnë për deputetin e tyre si përfaqësues dhe kjo e bën këtë deputet të japë llogari te votuesit e vet. Rritja e shkallës së magnitudës (numrit të përfaqësuesve që duhet

zgjedhur për një zonë) rritë shkallën e proporcionalitetit dhe siguron përfaqësim më të barabartë;

- Sistemi zgjedhor me një zonë ruan baraspeshën e votave të votuesve në tërë Kosovën; Minimumi i votave të nevojshme për të fituar mandat është i njëjtë në të gjitha anët e Kosovës pa marrë parasysh numrin e pakicave kombëtare në atë rajon;
- Duke pasur parasysh se argumenti i mësipërm qëndron, atëherë vërehet se një zonë zgjedhore nuk do të kishte efekt negativ në stimulimin e qytetarëve për të votuar. Vota e qytetarit ka rëndësi të barabartë në zgjedhjen e deputeti dhe kjo shërben si stimulim më i madh për të votuar;
- Një zonë zgjedhore gjithashtu garanton ruajtjen e kuotës gjinore, gjë që është tejet e rëndësishme duke qenë që kjo komponentë e sistemit zgjedhor ka qëndruar e paprekur nga Komisioni për Amandamentim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- Pragu zgjedhor mbetet i njëjtë për tërë Kosovën;
- Ky sistem përveç që ruan demokracinë e zgjedhjeve në Kosovë duke u siguruar që pesha e votuesit mbetet e njëjtë në tërë Kosovën, ai po ashtu siguron ruajtjen e të drejtave të komuniteteve duke i dhënë rëndësi garës në mes të partive minoritare për të fituar ulëset e garantuara në Kuvendin e Kosovës;
- Votimi në një zonë për një kandidat gjithashtu siguron votim më të thjeshtë për qytetarin, si dhe numërim më të thjeshtë. Kjo e bën sistemin më lehtë të menaxhueshëm, me kosto më të ulët, dhe me më pak gjasa të manipulimit gjatë numërimit të votave;
- Nuk ka vend për forcimin e një subjekti politik në dëm të subjekteve tjera si dhe sigurohet që votat e qytetarëve dhe vullneti i tyre në nivel vendi është i përfaqësuar në Kuvend;
- Duke pasur parasysh që INDEP kërkon të votohet për një kandidat me lista të hapura dhe pragu zgjedhor të jetë natyral (1%), atëherë një sistem i tillë i ofron mundësi të barabarta subjekteve të vogla politike, nismave rajonale dhe kandidatëve të pavarur. Pragu zgjedhor prej 1% siguron shkallë më të lartë pluraliteti politik dhe mundësi më të barabartë përfaqësimi të grupeve të ndryshme socio-politike.

### **Mangësitë:**

- Në publik mos ndryshimi i sistemit zgjedhor duke u bazuar në zona mund të krijojë ndjesinë se nuk është siguruar një sistem më i drejtë zgjedhor;
- Nuk forcohen liderët rajonal, por mbetet rëndësia e liderëve në nivel vendi. Kështu, ruhet rëndësia e zgjedhjeve lokale si për Asamble Komunale ashtu edhe për Kryetar Komune.

Duke u bazuar në argumentet e mësipërme shihet që propozimi i INDEP i adreson të gjitha problemet që sistemi zgjedhor i ka pasur deri më tani dhe gjithashtu siguron përfaqësim dhe llogaridhënie, baraspeshë të votës, votim demokratik dhe ruajtje të të drejtave të komuniteteve me anë të sistemit zgjedhor me një zonë.

Ndarja e Kosovës në zona zgjedhore dhe votimi për 100 deputetë në zona do të rrezikonte ruajtjen e kuotës gjinore, edhe pse ajo si e tillë nuk është prekur nga Komisioni për



Amandamentimin e Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme. Në rast se në 3 e më tepër zona zgjedhore nga një kandidat i gjinisë mashkullore i një partie fiton mandat, atëherë kuota gjinore nuk do të ruhet, duke pasur parasysh se ajo parti do të ketë 4 deputetë meshkuj, duke mos e përmbushur kuotën gjinore prej 30%.

Në anën tjetër, ndarja në zona gjithashtu do të forcojë liderët lokal në zgjedhje të përgjithshme duke i ulur rëndësinë zgjedhjes së deputetëve në Asamble Komunale dhe Kryetarëve të Komunave. Duke i shtuar kësaj edhe faktin që në të kaluarën kandidatët e subjekteve politike kandiduan në komunat prej nga e kanë prejardhjen por jo aty ku janë rezident dhe punojnë, na bën të kuptojmë se nëse kandidatët që fitojnë mandate në zona zgjedhore kanë vetëm prejardhjen prej atje e nuk janë rezident, atëherë nuk do të ketë përfaqësim rajonal por vetëm shfrytëzim të prejardhjes së kandidatëve për të siguruar vota në një rajon të caktuar. Sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, kandidatët kanë të drejtë të ndryshojnë vendbanimin e tyre deri një muaj para ditës së zgjedhjeve, gjë që e bën të lehtë që personat që janë rezident në Prishtinë të ndryshojnë vendbanimin e tyre vetëm përkohësisht gjatë kohës së zgjedhjeve.

Duhet cekur se diferenca në numrin e votave të nevojshme për një mandat nga një zonë në tjetrën rriten tutje nëse Kosova ndahet në më tepër se 10 zona pa marrë parasysh nëse mandatet që ndahen nga zonat janë 100 apo më pak. Kjo ndodhë sepse për dizajnimin e më tepër zonave ndarja do të jetë më e madhe dhe në zonat me komunat më të mëdha dhe me më shumë votues e numër më të vogël komunitetesh një mandat do të kërkojë më shumë vota se në zonat me komunat më të vogla, me më pak votues, dhe numër më të madh të komuniteteve.

Në anën tjetër, përfaqësimi i çdo rajoni në Kuvendin e Kosovës nuk është i domosdoshëm nëse i referohemi agjendës së Kuvendit të Kosovës dhe vendimeve të cilat merren aty. Kuvendi merr vendime, aprovon ligje dhe strategji të cilat kanë karakter shtetëror e jo rajonal. Në raste kur një rajon është i prekur nga vendimet e marra në Kuvend, kuvendet komunale dhe iniciativat lokale mund të shfrytëzojnë organet qendrore të partive të tyre dhe deputetët e tyre në Kuvend për të shtyrë përpara agjendën e tyre.

Duke pasur parasysh që Kosova është e ndarë në dy nivele administrative, atë qendror dhe lokal (komunal), për formimin e zonave zgjedhore dhe ndarjen rajonale të Kosovës do të ishte i nevojshëm një ligj i ri i cilit do të bënte ndarjen administrative të një nivel tjetër, atë rajonal (zonal). Kjo gjithashtu do të ndikonte në strukturën e Komisionit Qendror Zgjedhor, duke qenë e nevojshme ekzistenca e Kuvendit Zonal Zgjedhor si njësi shtesë në strukturën e Komisionit Qendror Zgjedhor. Këto çështje të ngritura përveç koston që do të shkaktonin, po ashtu do të kërkonin kohë për tu përpiluar dhe implementuar.

Ndarja e Kosovës në zona zgjedhore, gjithashtu do të krijonte një sistem më të komplikuar të votimit, që duke u bazuar në të gjeturat nga zgjedhjet e kaluara, mënyra e komplikuar e votimit shkakton paqartësi të votuesit, ndërsa mënyra më e komplikuar e numërimit të votave rritë numrin e parregullsive.

### 3. REKOMANDIME

Dukë marrë parasysh gjithë analizën e modeleve të ndryshme të ndarjes së Kosovës në zona zgjedhore, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) propozon që Kosova të mbetet një zonë e vetme zgjedhore, meqë secili opsion tjetër do të kishte më shumë pasoja sesa rezultate direkte në përmirësimin e nivelit të demokracisë.

Në mënyrë që kandidatët e pavarur dhe partitë apo iniciativat specifike qytetare të kenë pozitë të barabartë karshi forcave të mëdha politike, INDEP rekomandon që pragu zgjedhor të kthehet në kuotën natyrale prej 1%.

Sa i përket listave të kandidatëve dhe çështjes nëse ato do duhej të ishin të hapura, ku qytetarët do të mund të votonin drejtpërdrejt për kandidatë pos votës për subjektin politik, INDEP beson se kjo është një kategori kushtetuese e cila nuk duhet të ndryshohet. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e definon Kuvendin e Kosovës si një organ me 120 deputetë që zgjedhen me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura.<sup>7</sup> Termi listë e hapur, sipas definimeve të përgjithshme, është listë në të cilën votuesi ka influencë të vendosë se cilin kandidat do ta votoj drejtpërdrejt.<sup>8</sup>

Ky sistem do siguronte përfaqësimin rajonal dhe lokal, dhe do të mbronte peshën e votuesit dhe të drejtat e komuniteteve dhe po ashtu nuk do të lejojë favorizimin e partive dhe rajoneve të caktuara.

Përfaqësimi dhe llogaridhënia do të mundësohen - me anë të listave të hapura, votimit për një kandidat dhe pragut natyral – votuesit zgjedhin drejtpërdrejt për kandidatët që i votojnë (një votues- një votë), dhe në këtë mënyrë sigurohet përfaqësim i drejtpërdrejtë. Në anën tjetër me heqjen e pragut prej 5%, iniciativat rajonale e lokale, si dhe partitë e vogla inkurajohen për të kandiduar dhe u mundësohet garë e barabartë me partitë e mëdha për mandate në parlament.

Pesha e votës së secilit votues mbetet e njëjtë - kandidatët që fitojnë mandat në Kuvend, duhet të kenë numër minimal të votave të përafërt mes vete. Kjo do të ishte në disbalanc në rast të aplikimit të zonave, ku dallimi në mes të votave të nevojshme për të fituar mandat në zona ku numri pakicave është i konsiderueshëm me votat e nevojshme për të fituar mandat në zonat ku nuk ka numër të madh të pakicave është substancial. Në këtë mënyrë, proporcionaliteti do të ruhej dhe numri i votave do të pjesëtohej me numrin e deputetëve. Për të fituar një ulëse në Kuvendin e Kosovës duhen 1% të votave.

Kosova si një zonë zgjedhore gjithashtu i mbron të drejtat e komuniteteve sepse ato votojnë sipas preferencave të tyre në nivel kombëtar, duke mos pasur nevojë të deklarohen si komunitete pakicë (në rast të zonave virtuale). Një zonë zgjedhore gjithashtu siguron garë në mes të partive minoritare për ulëset e garantuara në Kuvend të Kosovës. Kjo rritë demokracinë brenda komuniteteve dhe gjithashtu siguron pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, gjë që nuk do të ndodhte në rast të ndarjes së Kosovës në zona zgjedhore.

---

<sup>7</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 64, paragrafi 1

<sup>8</sup> Stina Larserud and Rita Taphorn, IDEA Designing for Equality, International Institute for Democracy and Electoral Assistance, Stockholm, 2007

Votimi dhe numërimi i votave nuk do të komplikohet. Fletëvotimet e thjeshta në të cilat votohet për një kandidat në një zonë, e bën jo vetëm më të lehtë votimin për qytetarët por edhe procesin e numërimit për Komisionin Qendror Zgjedhor. Kjo gjithashtu zvogëlon koston e organizimit të zgjedhjeve, zvogëlon numrin e parregullsive dhe votave të pavlefshme, dhe në përgjithësi siguron një sistem të votimit shumë më lehtë të menaxhueshëm.

Votimi për një kandidat, siç ka rezultuar në të kaluarën në zgjedhjet komunale, zvogëlon dukshëm numrin e ankesave në Panelin për Ankesa dhe Parashtresa dhe po ashtu nuk lejon hapësirë për ankesa brenda partiake në diskursin publik.

ISBN 978-9951-627-02-3



9 789951 627023

INDEP 2012